

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 50
Prishtinë, më 22. 12. 2009, ora 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Luljeta Shehu, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Ibrahim Makolli, Danush Ademi , Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Lumni Rama – OSBE.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

Mbledhjen e kryesoi: Ismet Beqiri – kryetar.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Nxjerrja e rekomandimeve për moszbatim të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes kaluar.

Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjeve të kaluara.

3. Nxjerrja e rekomandimeve për moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Ismet Beqiri - I njoftoi për shkresën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për moszbatimin e vendimeve. Tha se moszbatimi i vendimeve të plotfuqishme e vë në dyshim ekzistencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Theksoi se komuna Gjilani ka një numër të madh të vendimeve të KPMK-së që nuk zbatohen, pastaj vijjnë komunat e Shtimes, Klina e të tjera. Për rastet e largimeve nga puna vuri në pah se skadimi i kontratës nuk është arsye për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Propozoi që KPMK-ja të mos i shqyrtojë vendimet e organit punëdhënës.

Në fund i propozoi Komisionit që pasi t'i grumbullojë materialet për vendimet e pazbatuara të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës një seance plenare.

Ibrahim Makolli – Për këtë dukuri duhet të mbështetemi në ligj. Për Raportin e KPMK-së dhe për gjendjen ekzistuese – për moszbatimin e vendimeve të KPMK-së, duhet të njoftohen Kuvendi dhe Qeveria (kryeministri). Ishte i mendimit se për këtë çështje duhet të informohet Ministria e Pushtetit Lokal, e cila pastaj i informon kryetarët e komunave. U pajtua me parafolësit se kjo çështje duhet të debatohet në një seancë plenare të radhës.

Hajredin Hyseni - Pati vërejtje në punën e Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës. Shtoi se nganjëherë i tejkalon kompetencat që ia lejon ligji. Kjo vërehet te zgjedhja e drejtorëve, kur u referohemi kualifikimit të tyre. Sipas tij rezulton se KPMK-ja nuk ka kompetencë t'i vlerësojë kualifikimet e drejtorëve.

Në fund ishte konstatim i përgjithshëm i Komisionit të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës të mbahet një seancë plenare, në të cilën do të debatohet për moszbatimin e vendimeve të KPMK-së.

Komisioni njëzëri u pajtua dhe nxori këtë

P e r f u n d i m

I. Komisioni do t'i kërkojë Kryesisë së Kuvendit të mbahet një seancë, plenare në të cilën do të debatohet për moszbatimin e vendimeve të KPMK-së.

II. Komisioni kërkon nga KPMK-ja ta grumbullojë materialin për vendimet e pazbatuara.

Të ndryshme

Kryetari - I njoftoi për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 03-P-223 të datës 3 dhjetor 2009, me të cilin ngarkohen komisionet e Kuvendit që secili nga fushëveprimi i tij t'i shqyrtojë pikat që i adresohen dhe t'i dërgohen Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian.

Ibrahim Makolli - Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se Qeveria ka një strategji të cilën ne si Kuvend nuk e kemi parë, kurse në anën tjetër po nxjerrim diçka të ngjashme. Në procesin e integritetit të gjitha institucionet duhet t'i bashkërendisin veprimtaritë e tyre. Është dashur të kërkohej nga Qeveria t'ia dorëzonte Kuvendit strategjinë.

Drita Maliqi – Tha se duhet të kërkojmë nga Qeveria që në fillim të vitit 2010 ta sjellë Ligjin për personat e pagjetur.

Komisioni vendosi që pasi ta shqyrtojë Raportin e Planit të veprimit t'ia dërgojë vërejtjet Komisionit Funkcional

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri